



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS

Raporti i vitit 2023 për procesin e konsultimit publik të realizuar nga agjencia shtetërore e programimit strategjik dhe koordinimit të ndihmës

1. *Përmbledhje ekzekutive*

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës ka miratuar projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030”, i cili është objekt i konsultimit publik sipas përcaktimeve të nenit 1 të ligjit nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.


Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë duke filluar nga data 31 Maj 2022 deri më 27 Korrik 2022. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar 16 takime konsultative publike në të cilat ishin të pranishëm rreth 560 pjesëmarrës dhe ku ishte e mundur marrja e komenteve të ndryshme nga partnerë Shqiptarë dhe të huaj, donatorë , institucione shtetërore, shoqëria civile dhe publiku nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Metodat e aplikuara për konsultimin e SKZHIE 2022 – 2030 janë përzgjedhur duke siguruar një qasje proaktive të të gjithë palëve të interesit në proces që në fazën e draftimit të dokumentit si dhe konsultim në faza të avancuara të tij, nëpërmjet:

- a. Takimeve të grupit të punës me përfaqësues të misionëve/partnerëve ndërkombëtarë që ofrojnë bashkëpunim dhe asistencë në fushën e zhvillimit dhe integritit të Shqipërisë dhe me përfaqësues të drejtorive përgjegjëse për draftimin e strategjive të reja të ministrive dhe agjensive shtetërore.;
- b. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK: nga 31.10.2022 deri më 30.11.2022;
- c. Npërmjet adresës së emailit: kelvin.strazimiri@saspac.gov.al;
- d. Npërmjet adresës postare: “Bulevardi Dëshmoret e Kombit” , Nr.1, Tiranë”.

Procesi i konsultimit publik është karakterizuar nga një numër i lartë aktorësh pjesëmarrës dhe komentesh e reagimesh të dërguara. Për shkak të natyrës specifike si një dokument ombrellë strategjik kombëtar, nuk është rasti për krahasim me periudha të mëparshme raportimi.

Grafik1: Realizimi i procesit të konsultimit publik për gjashtëmuja të parë të 2023



Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për këtë projektakt ka patur një numër prej 2208 vizitorësh në total.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2022

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara nga SASPAC për gjashtëmuja të parë të 2023 është 3 projektakte.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”, është i vetmi akt objekt i konsultimit publik miratuar për periudhën dhe i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.1.3 Sa ligje me raport VNR-je janë konsultuar?

Vlerësimi i ndikimit rregullator nuk aplikohet për këtë projektvendim, bazuar në përcaktimet e pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.1.4 Për sa akte në a) Program Analitik, PKIE, Dokumenta strategjik janë përdorur kriteret përjashtuese nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

a) Në planin analitik të vitit 2023 SASPAC ka parashikuar miratimin e 12 projekt-akteve, nga të cilat vetëm 1 projektvendim i nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Kriteret përjashtuese parashikuar në nenin 4 të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, aplikohen për 11 prej tyre.

b) Në PKIE 2022 -2023 SASPAC ka parashikuar miratimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Ndër-sektoriale të Ekonomisë Blu 2023 -2030”, për të cilin aplikohet procesi i konsultimit publik. Nuk ka kritere përjashtuese të aplikuara.

c) Kritere përjashtuese aplikohen vetëm për 10 akte, të planifikuara për miratim përgjatë vitit 2023 dhe që lidhen me kuadrin strategjik kombëtar apo sektorial.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrorë, etj.)?

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”.

2.2 Metodat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.

Projektakti u konsultua në faqen zyrtare të konsultimit publik <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538>). Për secilin kapitull të SKZHIE 2022-2030 u mbajtën tryeza konsultimi me institucionin përgjegjës, grupet e interesit dhe donatorët.

Metodat e përdorura të konsultimit ishin:

- 1.Regjistri elektronik;
- 2.Takime me grupet e interesit dhe donatorët;
- 3.Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore – Vetëqeverisje Vendore
- 4.Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave;
- 5.Email.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit.

2.2.3 A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

SASPAC realizoi konsultime paraprake për projektvendimin e sipërcituar me secilin institucion veçmas.

2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian u konsultua përmes faqes web të konsultimit publik nga data 31.10.2022 deri në datën 25.11.2022, për 25 ditë.

Gjatë periudhës maj-korrik u mbajtën takime për secilin kapitull të SKZHIE, ku institucioni përkatës prezantonte kapitullin dhe grupet e interesit jepnin komentet dhe sugjerimet e tyre, në formë parimore dhe në vijim sugjerime konkrete për përmirësimin.

Më datë 20 tetor 2022, pranë Pallatit të Kongreseve, Salla Albanologjike u zhvillua takimi me përfaqësues të institucioneve ku u prezantua drafti i integruar i SKZHI 2022 - 2030 dhe indikatorët e performancës.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja e konsultimit publik ishte 183 ditë kalendarike, duke konsideruar datën 31 maj 2022 kur u zhvilluan takimi i parë konsultativ dhe 30 nëntor 2022 e cila është data finale e konsultimit të hapur në RENjKP.

2.3.3A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

N/A

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

4 aktorë të jashtëm në rolin e ekspertë morën pjesë në procesin e hartimit të SKZHIE 2022 – 2030.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Ekspertë individualë ishin anëtarë të jashtëm të grupeve të punës si dhe institucione akademike.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

560 palë interesi morën pjesë në procesin e konsultimit publik. 41 prej tyre dhanë komente për aspekte të ndryshme të SKZHIE 2023-2030.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

- Partnerët e huaj për zhvillim;
- Delegacioni i BE;
- Donatorë dhe ambasada;
- Institucione shtetërore dhe ministritë e linjës.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

N/A

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra


2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Numri i komenteve të marra gjithsej është 75.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Gjithsej 35 komente u pranuan, 23 u pranuan pjesërisht dhe 17 u refuzuan.

Grafik 2: Shkalla e pranimit të komenteve



2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

N/A

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Vlerësimi i ndikimit rregullator nuk aplikohet për këtë projektvendim, bazuar në përcaktimet e pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Institucioni publikoi 1 raport konsultimi.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyt?

Nuk ka raport të pa publikuar.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Nisur nga zbatimi i kërkesave e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në zbatim të “Udhëzuesit për Procesin e Konsultimit Publik”, vetëvlerësimi institucional për procesin e kryer të konsultimit publik për aktin është 8 pikë.

3 Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

SKZHIE 2022 – 2030 si dokumenti më i rëndësishëm strategjik kombëtar që përcakton fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integritetit të saj në Bashkimin Evropian, i është nënshtruar një procesi të zgjeruar dhe efektiv konsultimi publik.

Aktorët e përfshirë në proces përbëjnë institucionet ndërkombëtare prezent në vend, aktorë të rëndësishëm kombëtar, institucionet shtetërore dhe publiku. Procesi është karakterizuar nga zbatimi i parimeve themelore dhe përmbushja e kërkesave dhe standardeve për konsultimin publik.

Komentet dhe reagimet e mbledhura janë reflektuar në një shkallë të lartë në draftin final të dokumentit, duke siguruar kështu një dokument strategjik kombëtar cilësor, të gjithë pranuar dhe që siguron zhvillim.